

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Krimeve të Rënda, në trupin gjykues, të përbërë nga gjyqtarët Afrim Shala, kryetar i trupit gjykues, Ilmi Dalipi dhe Mirevete Alidemi, anëtarë të trupit gjykues, me sekretaren juridike Vahide Dërmaku, në çështjen penale ndaj të akuzuarit S. O., nga fshati B., Komuna Quqerr-Sandevë, Republika e Maqedonisë, me vendqëndrim në fshatin L., Komuna e V., për shkak të veprës penale kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare, nga neni 146 paragrafi 1 dhe 3 nënparagrafi 3.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës,¹ të cilin sipas autorizimit e mbron avokati Rr. L., nga Gjilani, sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, PPS.nr.42/2015, e datës 19.08.2015, të cilën e përfaqësonte prokurori Faik Halili, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 15.10.2015, në të njejtën datë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datën 19.10.2015, e përpilojë me shkrim këtë :

AKTGJYKIM

I akuzuari S. O., nga babai M. dhe nëna M., e lindur B., i lindur më ..., në fshatin B., Komuna Q.-S., Republika e Maqedonisë, me vendqëndrim në fshatin L., Komuna e V., shqiptar, shtetas i Republikës së Maqedonisë, me numër personal ..., i martuar, babë i ... fëmijëve, ..., i gjendjes së varfër ekonomike, ka të kryer shkollën e ..., më parë nuk ka qenë i dënuar për vepra tjera penale,

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datën ...2015, ka kaluar kufirin në mes të Republikës së Kosovës dhe të asaj të Maqedonisë, në afërsi të fshatit B., të Maqedonisë, jashtë kufirit apo vendkalimit të autorizuar kufitar, të fshatit L. Komuna e V., Republika e Kosovës, ku me rastin e kalimit të kufirit në mënyrë ilegale, me vete ka poseduar edhe armë,

- me këtë ka kryer vepër penale kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare, nga neni 146 paragrafi 1 dhe 3 nënparagrafi 3.4 të KPRK.

¹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPRK), nr.04/L-082, i datës 20.04.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

Andaj, trupi gjykues, në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 42, 43, 45, 69, 73, 74, 75 dhe 76 të KPRK, si dhe nenit 282 paragrafi 1 dhe 2 nënparagrafi 2.1 dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale,² të akuzuarit i shqipton :

DËNIM ME BURGIM

Ashtu që të akuzuarit S. O., i caktohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 100 (njëqind) ditëve, të cilin dënim do ta mbaj pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Sa i përket kësaj çështje penale, ndaj të akuzuarit S. O., ndërprehet paraburgimi më datën10.2015.

Në dënimin e shqiptuar me burgim, të akuzuarit S. O., do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës07.2015 e deri më datën10.2015, në atë mënyrë që 1 (një) ditë e qëndrimit në paraburgim barazohet me 1 (një) ditë të dënimit me burgim.

Konfiskohet arma e zjarrit e markës "...", e kalibrit ... mm, me numër serik ..., ... karikator dhe ... copa fishkë, të kalibrit ...mm.

Detyrohet i akuzuari S. O., që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë shumën prej 50 €, në emër të paushallit gjyqësor në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

ARSYETIMI

1. Ecuria e procedurës dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Speciale e Kosovës, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të akuzuarit S. O., nga fshti B., Komuna Q.-S., Republika e Maqedonisë, me vendqëndrim në fshatin L., Komuna e V., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK dhe veprës penale kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare, nga neni 146 paragrafi 1 dhe 3 nënparagrafi 3.2 dhe 3.4 të KPRK.

Seanca e shqyrtimit fillestar, në këtë çështje penale është mbajtur më datën2015, ndërsa seanca e shqyrtimit të dytë, është mbajtur më datën2015.

² Kodi i Procedurës Penale (Në tekstin e mëtejme KPP), nr.04/L-123, i datës 13.12.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

Kryetari i trupit gjykues, me aktvendimin e datën2015, e ka aprovuar pjesërisht kundërshtimin e mbrojtësit të të akuzuarit S. O., avokatit Rr. L. dhe e ka hedhur aktakuzën e lartcekur të Prokurorisë Speciale të Kosovës, vetëm sa i përket veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK (Dispozitivi I i aktakuzës).

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, i cili është mbajtur më datën ...10.2015, pas leximit të aktakuzës dhe pas konsultimit me mbrojtësin e tij, i akuzuari S. O., ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, duke shtuar se e pranojë fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale.

Meqenëse i akuzuari S. O., e ka pranuar fajësinë, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me fjalën përfundimtare, ku prokurori Faik Halili, ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës, sa i përket veprës penale kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare, nga neni 146 paragrafi 1 dhe 3 nënparagrafi 3.2 dhe 3.4 të KPRK, duke i propozuar trupit gjykues që i akuzuari S. O., të shpallet fajtor dhe dënohet sipas dispozitave ligjore në fuqi. Me rastin e shqiptimit të dënimit, si rrethanë veçanërisht lehtësuese të merret për bazë fakti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë.

I akuzuari S. O. dhe mbrojtësi i tij, avokati Rr. L., gjatë fjalës përfundimtare i kanë propozuar trupit gjykues që ndaj të akuzuarit të shqiptojë një dënim më i butë, ngase i akuzuari se është penduar për kryerjen e kësaj vepre penale dhe ka gjendje të varfër ekonomike.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Trupi gjykues, pas dëgjimit të palëve dhe të mbrojtësit të të akuzuarit, avokatit Rr. L., ka marrë aktvendim për pranimin e fajësisë, ngase ka ardhur në përfundim se i akuzuari S. O., e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, avokatin Rr. L.; se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, trupi gjykues e ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

- se i akuzuari S. O., me dashje e ka kryer veprën penale kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare, nga neni 146 paragrafi 1 dhe 3 nënparagrafi 3.4 të KPRK.

4. Elementet e veprës penale dhe rikualifikimi ligjor i veprës penale

Në nenin 146 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar se formën themelore të veprës penale kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare, e kryen “Kushdo që kalon kufirin apo vijën kufitare të Republikës së Kosovës në cilindo vend përveç në kufirin apo vendkalimet e autorizuara kufitare” dhe për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me 250 € (dyqind e pesëdhjetë Euro) gjobë ose me burgim deri në 6 (gjashtë) muaj. Ndërsa, në paragrafin 3 të këtij neni është parashikuar se “kur vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet në një apo më shumë nga rrethanat e mëposhtme, kryesi dënohet me burgim prej 6 (gjashtë) muaj deri në 3 (tre) vjet nëse:

3.1. kryesi ka qenë më parë i dënuar për vepër penale nga ky nen;

3.2. gjatë kohës së kapjes, kryesi ikë, përpiqet të ikë ose në ndonjë mënyrë tjetër i reziston kapjes nga policia ose KFOR-i;

3.3. kalimi është bërë ndërmjet orës tetë (8:00) në mbrëmje deri në orën gjashtë (6:00) në mëngjes gjatë periudhës prej 1 prillit deri më 30 shtator, ose ndërmjet orës gjashtë (6:00) në mbrëmje deri në orën gjashtë (6:00) në mëngjes gjatë periudhës prej 1 tetorit deri më 31 mars; ose

3.4. kryesi posedon armë, municion ose rroba ushtarake, furnizime apo pajisje.

Pas pranimit të fajësisë, trupi gjykues e shpalli fajtor të akuzuarin S. O., për shkak të veprës penale kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare, nga neni 146 paragrafi 1 dhe 3 nënparagrafi 3.4 të KPRK, ngase veprimet e të njejtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njejtën është edhe penalisht përgjegjës. Kjo për faktin se i njejtë, siç e ka pranuar edhe vetë, me datën ...2015, ka kaluar kufirin në mes të Republikës së Kosovës dhe të asaj të Maqedonisë, në afërsi të fshatit B., të Maqedonisë, jashtë kufirit apo vendkalimit të autorizuar kufitar, të fshatit L. Komuna e V., Republika e Kosovës, ku me rastin e kalimit të kufirit në mënyrë ilegale, me vete ka poseduar edhe armë. Mirëpo, trupi gjykues, duke u bazuar në nenin 360 paragrafi 2 të KPP,³ nuk e ka aprovuar propozimin e prokurorit special, që i akuzuari S. O., të shpallet fajtor për shkak të veprës penale kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare, nga neni 146 paragrafi 1 dhe 3 nënparagrafi 3.2 dhe 3.4 të KPRK, por të njëjtin e ka shpallur fajtor vetëm për shkak të veprës penale kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare, nga neni 146 paragrafi 1 dhe 3 nënparagrafi 3.4 të KPRK. Kjo për faktin se në dispozitivin e aktakuzës së lartcekur (përshkrimi i veprimeve inkriminuese), askund nuk është shënuar që i akuzuari S. O., me rastin e kryerjes së kësaj vepre penale, gjatë kohës së kapjes, i njejtë të ketë ikur; të jetë përpikur që të ikë, ose në ndonjë mënyrë tjetër ti ketë rezistuar kapjes nga policia ose KFOR-i. Këto njëherit i përbëjnë edhe elementet e veprës penale sipas nënparagrafit 3.2 paragrafi 3 të nenit 146 të KPRK, kështu që meqë në aktakuzë nuk janë përshkruar veprimet e kryerjes që ndërlidhen me këto elemente, atëherë

³ Në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se “gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës”.

trupi gjykues, të akuzuarin S. O., e ka shpallur fajtor vetëm për shkak të veprës penale kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare, nga neni 146 paragrafi 1 dhe 3 nënparagrafi 3.4 të KPRK.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit S. O., trupi gjykues i ka marrë për bazë disa rrethana që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 73, 74 dhe 75 të KPRK. Në këtë aspekt, duke vepruar edhe sipas propozimit të prokurorit special, si rrethanë posaçërisht lehtësuese, mbi bazën e së cilës trupi gjykues e ka zbutur dënimin, është fakti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe këtë e ka bërë gjatë të gjitha fazave të procedurës penale. Kjo është një rrethanë e cila duke e ndërlidhur me rrethanat tjera të shënuara më poshtë, tregojnë se edhe me një dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit dhe i akuzuari me të drejtë mund të pritët që në të ardhmen nuk do të kryejë ndonjë veprë tjetër penale. Përveç kësaj, si rrethana tjera posaçërisht lehtësuese, trupi gjykues e ka marrë për bazë edhe faktin se i akuzuari para trupit gjykues ka deklaruar se është penduar thellë për kryerjen e kësaj veprë penale; se sipas deklaratës së të akuzuarit të cilës trupit gjykues ja ka falur besimin, i njëjti është i martuar dhe është babë i tetë fëmijëve; sjelljet e mira të të akuzuarit gjatë seancave gjyqësore dhe nuk është siguruar ndonjë dëshmi që i njëjti më parë të ketë qenë i dënuar për ndonjë veprë tjetër penale. Andaj, duke i marrë për bazë të gjitha këto që u cekën më lartë, trupi gjykues ka vlerësuar se në rastin konkret ekzistojnë rrethana posaçërisht lehtësuese, të cilat tregojnë se edhe me një dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit. Për këto arsye, trupi gjykues ka vlerësuar se shqiptimi i dënimit në kuadër të minimumit dhe maksimumit të posaçëm të kësaj forme të veprës penale, me të vërtetë, duke i marrë për bazë të gjitha këto rrethana posaçërisht lehtësuese, do të ishte një dënim shumë i rëndë për të akuzuarin.

Kurse, në anën tjetër, trupi gjykues nuk ka gjetur ndonjë rrethanë rënduese për të akuzuarin S. O..

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimeve të shqiptuara

Sipas bindjes së trupit gjykues, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 100 (njëqind) ditëve ndaj të akuzuarit S. O., duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit.

Trupi gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të

të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi lidhur me paraburgimin

Trupi gjykues, ka vendosur që ndaj të akuzuarit S. O., sa i përket kësaj çështje penale, të ndërprehet paraburgimi më datën2015, ngase kanë pushuar së ekzistuar të gjitha arsyet ligjore për mbajtjen e mëtejme në paraburgim.

Gjithashtu, duke u bazuar në nenin 83 paragrafi 1 dhe 4 të KPRK, është vendosur që në dënimin e shqiptuar me burgim, të akuzuarit S. O., do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës ...07.2015 e deri më datën ...10.2015, në atë mënyrë që 1 (një) ditë e qëndrimit në paraburgim barazohet me 1 (një) ditë të dënimit me burgim.

8. Vendimi për konfiskimin e armëve

Trupi gjykues, duke u bazuar në nenin 282 paragrafi 1 dhe 2, nënparagrafi 2.1. të KPP, pavarësisht faktit se është hedhur aktakuza për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK, ka vendosur që ta konfiskojë armën e zjarrit e markës “..”, e kalibrit ... mm, me numër serik ..., karikator dhe ... copa fishkë, të kalibrit ...mm, për shkak se i akuzuari nuk ka patur autorizim që ta mbajë një armë të tillë dhe konfiskimi i saj është në interes të sigurisë së përgjithshme.

9. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarit, trupi gjykues duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të akuzuarin ta detyrojë për ta paguar vetëm paushallin gjyqësor në shumë prej 50 Euro, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në arsyet që u cekën më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Krimeve të Rënda

Më 19.10.2015

Sekretarja juridike,

Kryetari i trupit gjykues,

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.